

URDHËR
Nr. 299, datë 29.7.2020

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE USHQIMORE
PËR KONSUM NJERËZOR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 2, të ligjit nr. 8/2019, datë 26.2.2019 “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e listës së produkteve bujqësore dhe ushqimore për konsum njerëzor, sipas fushës së zbatimit të ligjit nr. 8/2019, datë 26.2.2019, “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

ANEKS 1

LISTA E PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE USHQIMORE PËR KONSUM NJERËZOR
SIPAS FUSHËS SË ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 8/2019, DATË 26.2.2019 “PËR SKEMAT E
CILËSISË SË PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE USHQIMORE”

Klasa e 1-rë	Mish i freskët (dhe të brendshmet), që përfshin: - mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të mishit; - të brendshmet (zorrët), fshikëzat dhe stomakët e kafshëve (përveç atyre të peshkut), të plota dhe pjesë prej tyre.
Klasa e 2-të	Produkte mishi (të gatuar, të kripur, të tymosur etj.).
Klasa e 3-të	Djathërat.
Klasa e 4-t	Produkte të tjera me origjinë shtazore (vezë, mjaltë, produkte bulmetore të ndryshme përveç gjalpit etj.).
Klasa e 5-të	Vajra dhe yndyrna (gjalpë, margarinë, vaj etj.), që përfshin: - gjalpë, yndyrna dhe vajra të tjera të rrjedhura nga qumështi; - sallo dhe dhjam derri; dhjam i shpendëve; - dhjamë gjedhi, delesh ose dhish; sallo (përfshirë <i>premier jus</i>) prodhuar nga këto dhjamëra; - stearina e sallos së dërrit, vaj salloje, oleostearinë, oleo-margarinë dhe vaj prej dhjamt, jo në formë emulsive apo të përzier apo të përgatitura ndryshe; - dhjamëra dhe vajra dhe fraksionet e tyre, të peshkut apo të gjitarëve detarë, nëse janë apo jo të rafinuara; - vajra vegjetale të fiksuara, të lëngshme ose të ngurta, të papërpunuara, të rafinuara ose të purifikuara; - dhjamëra dhe vajra shtazore ose vegjetale, të hidrogenizuara, të rafinuara ose jo, por jo të përgatitura më tej; - margarinë, imitim lardoje dhe dhjamëra të ngrënshme të përgatitura më tej; - mbetjet e rezultuara nga përpunimi i substancave yndyrore apo i dylleve vegjetale apo prej kafshëve.

Klasa e 6-të	Fruta, perime dhe drithëra, të freskët apo përpunuar, që përfshin: - frutat dhe arrat e ngrënshme; lëkurat e agrumeve apo të pjeprave; - zarzavatet e ngrënshme, rrënjët dhe tuberët përkatës; - drithërat; - produktet e industrisë bluajtëse; mjaltë dhe niseshte; gluten; inulinë; - përgatitje prej zarzavateve, frutave, arrave apo pjesëve të tjera të bimëve; - pije të tjera të fermentuara (p.sh., musht molle, musht dardhe, hidromel); - uthull dhe zëvendësuesit e uthullës.
Klasa e 7-të	Peshk i freskët, molusqe dhe kafshët guaskore dhe produktet që rrjedhin prej tyre.
Klasa e 8-të	Produkte të tjera, që përfshin: - kafë, çaj dhe erëza, përjashtuar mate; - farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe tagjia; - pektin; - sheqer i prodhuar nga kallam sheqeri apo nga panxhar sheqeri në gjendje të ngurtë; - sheqer tjetër, shurupe sheqeri, mjaltë artificial (i përzier ose jo me mjaltë natyral), karamel; - melasat, me lëndë ngjyruese shtesë ose jo; - sheqer, shurupe, melasë me lëndë shtesë aromatizuese dhe ngjyruese, por që nuk përfshin lëngjet e frutave të cilat përmbajnë sheqer shtesë në çfarëdo mase; - kokrra kakao, të tëra apo të thyera, të papërpunuara apo të pjekura; - lëvozhga, lëkura, guaska e kakaos dhe mbeturina të tjera prej kakaos.
Klasa e 9-të	Ushqime të përgatitura.
Klasa e 10-të	Birrë.
Klasa e 11-të	Çokollatë dhe produkte që rrjedhin prej saj.
Klasa e 12-të	Bukë, torta, kek, ëmbëlsira, biskotat dhe produkte të tjera të furrtarit.
Klasa e 13-të	Pije bërë nga ekstraktet bimore.
Klasa e 14-të	Brumërat.
Klasa e 15-të	Kripë.